

Raporti javorë për 04-10 qershorë 2018

Monitorimi i qasjes në të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e refugjatëve dhe emigrantëve në qendrat tranzit-kufitare Tabanovcë (kufiri i veriut) dhe Gjevgjeli (kufiri jugor)

Legis është një partner-organizatë zbatuese e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Fondacionit Vlade i Ana Divac, Qendrës Humanitare e Novi Sadit - NSHC dhe Arbeiter-Samariter-Bund Deutschland në projektin: **Ndihmë në Rrugë (Help on the route) - Mbrojtja e drejtave të njeriut, të refugjatëve dhe emigrantëve që kalojnë nëpër Maqedoni dhe Serbi**. Lidhur me këtë, Legis ka **6 punëtorë në terren dhe 2 koordinatorë** të cilët mbledhin informacione të përditshme në lidhje me aksesin në të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e banorëve në qendrat tranzit kufitare Tabanovce në veri dhe Gjevgjeli në kufirin jugor.

Prandaj, ky raport javor përfaqëson një përmbledhje të:

- **Numrit të raporteve:** 12 raporte ditore në total, gjegjësisht pyetësorë të mbledhur gjatë kësaj periudhe.

Numri i përgjithshëm i refugjatëve / migrantëve të mbështetur: gjatë kësaj periudhe janë mbështetur/ndihmuar rreth 32 refugjatë / emigrantë, pasi që të sapoardhurit lëvizin pothuajse çdo ditë, zyrtarët tanë në terren kanë arritur të komunikojnë me pothuajse çdo person të sapoardhur në kampin në Tabanovcë, përderisa kampi në kufirin jugor Vinojug, Gjevgjeli mbetet i mbyllur dhe me 30-14 banorë. Gjatë kësaj periudhe raportuese 24-5 persona të regjistruar qëndruan në Tabanovcë. Për më tepër, në Tabanovcë ka pasur njëmbëdhjetë të ardhur të rinjë: shtatë nga Irani, një nga Palestina, dy nga Afganistani dhe një nga Sirija. Katër të ardhur të rinjë u regjistruan në qendrën në Vinojug, Gjevgjeli: dy persona nga Iraki dhe dy nga Libija.

Tabanovcë, kufiri veriorë

Objektet dhe kushtet:

Qendra tranzitore në Tabanovcë, Kumanovë ka objekte të përkohshme të banimit (kontejnerë) për rezidentët me kushte të kënaqshme për ngrohje dhe ftohje. Të gjithë banorët kanë qasje në objektet për higjienë, në kuzhinë dhe në hapësira rekreative për fëmijë etj.

Ata shërbehen me tre vakte ushqimore në ditë. Tualetet pastrohen çdo ditë. Liria e lëvizjes vazhdon të jetë e kufizuar, domethënë banorët mund të dalin, por vetëm nëse shoqërohen nga



stafi i kampit. Të gjithë rezidentët kanë nxemje në dispozicion, poashtu edhe ujë të ngrohtë nëpër banjo. Tashmë rezidentët akses në internet, i siguar nga ana e IOM-it. Pas disa kontrolleve të kryera nga ekipi ynë, u konstatua se zona e përbashkët menjëherë jashtë kuzhinës ishte shumë e ndytë dhe e papastër, sidomos tryezat dhe karriget ku rezidentët ulen të hajnë ushqim dhe/ose të socializohen dhe në atë pjesë kishte të pranishëm shumë qenë të pa strehë.

Trajtimi institucional

Asnjë parregullësi institucionale nuk është raportuar.

Qasja në azil ose në mbrojtje të përkohshme:

Të gjithë banorët kanë qasje në azil ose në mbrojtje të përkohshme përmes sektorit të azilit të ministrisë së brendshme dhe OJQ-së. Shoqata e juristëve të rinjë të Maqedonisë dhe gjithashtu kanë qasje në ndihma tjera juridike sipas nevojës. Sidoqoftë nuk ka pasur kërkesa të reja për azil.

Qasja në shërbime: kujdes shëndetësor, nevoja mjekësore, ushqim dhe artikuj jo ushqimorë:

Të gjithë banorët kanë qasje në kujdesin bazë shëndetësor, ndihmë mjekësore, ushqim dhe në sende jo ushqimore. Gjatë kësaj periudhe nuk pati kërkesa të veçanta mjekësore nga banorët. Stafii mjekësor është gjithmonë i pranishëm në kamp. Në raste të caktuara, rezidentët dërgohen për kontrollë shtesë në spitalin e Kumanovës. Nuk u raportuan nevoja të posaqme mjekësore gjatë kësaj periudhe.

Kufizimi i lëvizjes:

- Banorët mund të dalin jashtë kampit, mund të shkojnë në marketet lokale për të blerë gjëra që ju nevojiten, kurdo që të kenë dëshirë, mirëpo paraprakisht duhet të informojnë policët tek hyrja e kampit se ku do të shkojnë dhe në çfarë kohe do të kthehen. Më herët, kishte orarë të paraparë, se gjatë cilëve orë rezidentët mund të dalin nga kampi.

Gjevgjeli, kufiri jugor:

Objektet dhe kushtet:

Si kur se qendra tranzitore në Tabanovcë, edhe ajo në Gjevgjeli ka objekte të përkohshme të banimit (kontejnerë) për rezidentët me kushte të kënaqshme për ngrohje dhe ftohje. Rutina e përditshme e banorëve në kamp varet nga programet brenda objekteve të qendrës, pasi kufizimi i lëvizjes nuk është hequr. Rezidentëve iu jepet ushqim i cili ka qenë i gatuar paraprakisht (vetëm



ushqimin e drekës) vetëm tre herë në javë. Ditëve tjera të javës, në përputhshmëri dhe aq sa u'a lejonë buxheti i tyre, kryqi i kuq blen ushqime për rezidentët. Rezidentët ankohen për mungesë të ushqimit dhe kualitetit të dobët edhe të ushqimit të pakët. Tualetet dhe banjot, pastrohen rregullisht. Tashmë rezidentët kanë qasje në internet.

Trajtimi institucional:

Në total 26¹ shtyrje-mbrapa (push-backs) u kryen nga policija maqedonase: nëntëmbëdhjetë persona nga Pakistani dhe shtatë nga Irani.

Qasja në azil ose mbrojtje e përkohshme:

Të gjithë banorët kanë qasje në azil ose mbrojtje të përkohshme përmes sektorit të azilit të ministrisë së brendshme dhe përmes OJQ-së lokale Shoqata e juristëve të rinjë të Maqedonisë dhe gjithashtu kanë qasje në ndihma tjera juridike sipas nevojës. Mirëpo, asnjë kërkesë për azil apo për mbrojtje të përkohshme nuk është dorëzuar gjatë kësaj periudhe raportuese.

Qasja në shërbime: kujdes shëndetësor, nevoja mjekësore, ushqim dhe artikuj jo ushqimorë:

Të gjithë banorët kanë qasje në kujdesin bazë shëndetësor, ndihmë mjekësore, në ushqim dhe në sende jo ushqimore. Gjatë kësaj periudhe nuk u raportuan nevoja të veçanta mjekësore. Stafi mjekësor është gjithmonë i pranishëm në kamp. Në raste të caktuara, rezidentët dërgohen në spitalet e qytetit të Gjevgjelisë apo Strumicës për kontrolle më të tutjeshme. Tashmë ka nevojë për më shumë tesha verore, si maica, këpuca verore, lodra të fëmijëve, frute dhe perime të freskëta.

Kufizimi i lëvizjes:

- Banorët mund të dalin vetëm nëse shoqërohen nga stafi i kampit ose kryqi i kuq.

- Numri i rasteve të referuara në zyrën e Ombudsmanit gjatë kësaj periudhe:

/

¹ Ky numër është i përafërt. Mundet që të jetë më i madh, mirëpo ky numër është ai i cili punëtorët tanë në terren kanë arritur që ta mësojnë gjatë kësaj periudhe.